

**VENDIM**

**Nr.850, datë 21.10.2010**

**PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSIMIT VJETOR,  
INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

- 1.** Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve, sipas viteve, të jenë, si më poshtë vijon:

Për vitin 2009 1.00; Për vitin 2008 1.04;

Për vitin 2007 1.11;

Për vitin 2006 1.04;

Për vitin 2005 1.02;

Për vitin 2004 1.12;

Për vitin 2003 1.10;

Për vitin 2002 1.09;

Për vitin 2001 1.14;

Për vitin 2000 1.07;

Për vitin 1999 1.09;

Për vitin 1998 1.05;

Për vitin 1997 1.22;

Për vitin 1996 1.09;

Për vitin 1995 1.37;

Për vitin 1994 1.32.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, janë vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2010 dhe përballohen nga buxheti i vitit 2010, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.
  
3. Vendimi nr.642, datë 11.6.2009 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2010.

**KRYEMINISTRI**

**Sali Berisha**